FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 111

Tiranë – E hënë, 30 korrik 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 38/2018 datë 5.7.2018	Për ratifikimin e korrigjimit të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huan e politikës së zhvillimit të sektorit financiar.....	6825
Ligj nr. 40/2018 datë 9.7.2018	Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.....	6826
Ligj nr. 41/2018 datë 9.7.2018	Për një shtesë në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.....	6826
Ligj nr. 42/2018 datë 9.7.2018	Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e sistemit për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal (PISCES)	6827
Ligj nr. 43/2018 datë 9.7.2018	Për ratifikimin e protokollit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar	6829
Ligj nr. 44/2018 datë 19.7.2018	Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor.....	6833
Ligj nr. 45/2018 datë 19.7.2018	Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës.....	6837
Akt Normativ i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 26.7.2018	Për disa ndryshime në ligjin nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018"..	6842

LIGJ
Nr. 38/2018

PËR RATIFIKIMIN E KORRIGJIMIT TË MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR HUAN E POLITIKËS SË ZHVILLIMIT TË SEKTORIT FINANCIAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet korrigjimi i marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huan e politikës së zhvillimit të sektorit financiar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.7.2018

Shpallur me dekretin nr. 10842, datë 26.7.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

BANKA BOTËRORE
BNRZH - IDA GRUPI I BANKËS BOTËRORE

ZYRA E GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE
Praterstrasse 31/21
Vienna, Austria, 1020

Lindda Van Gelder
Drejtore Rajonale, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe i Azisë Qendrore

23 janar 2018

Shkëlqesisë së Tij, z. Arben Ahmetaj
Ministër
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë
Shqipëri

I nderuar z. ministër,

Huaja e politikës së zhvillimit të sektorit financiar
(huaja nr. 8698-Al)
Korrigjim në Marrëveshjen e Huas

Ne i referohemi Marrëveshjes së Huas për projektin e përmendur më lart, të datës 20 mars 2017, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Bankës).

Qëllimi i këtij korrigjimi është korrigjimi i dy datave të fundit të shlyerjes dhe i kësteve përkatëse (të shprehura si përqindje). Si rrjedhojë, data "15 shtator 2048" është rishikuar dhe lexohet "15 mars 2048, me këst (të shprehur në përqindje) prej 2.08%" dhe vendoset një datë e re dhe përfundimtare shlyerjeje, konkretisht "15 shtator 2048, me këst (të shprehur në përqindje) prej 2.24%", siç parashtrohet në tabelë, në skedulin 2 të Marrëveshjes së Huas për veprimin e referuar më lart.

Ju lutem, gjeni bashkëlidhur tabelën e korrigjuar në skedulin 2 të Marrëveshjes së Huas.

Ky korrigjim hyn në fuqi në datën e kësaj letre. Do ta vlerësonim shumë nëse do të mund të na dërgoni sa më herët që të jetë e mundur konfirmimin e marrjes së kësaj letre.

Me respekt
(nënshkrimi)

Linda Van Gelder
Drejtore Rajonale, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe i Azisë Qendrore
Tel.: +43 (1) 2170 782
Fax: +43 (1) 2170 701

Shkëlqesisë së Tij, Arben Ahmetaj

23 janar 2018

SKEDULI 2

Data e pagesës së principalit	Kësti (i shprehur si përqindje)
Në çdo datë 15 mars dhe 15 shtator Duke filluar nga data 15 mars 2025 deri më 15 mars 2048	2.08%
Më 15 shtator 2048	2.24%

Tel.: +43 (1) 2170 782; fax: +43 (1) 2170 701

LIGJ
Nr. 40/2018

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR. 92/2014, "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

Neni 1

Në nenin 49, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

"5. Për strukturat, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit, aplikohet shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar 6 për qind për furnizimin e shërbimit të akomodimit dhe restorantit, me përjashtim të pijeve. Personi i tatueshëm, që aplikon shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar 6 për qind, është personi i regjistruar me NIPT/NUIS, vetëm për zhvillimin e veprimtarisë pritëse të certifikuar si "agroturizëm"".

Neni 2

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019.

Miratuar në datën 9.7.2018

Shpallur me dekretin nr. 10843, datë 26.7.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

LIGJ
Nr. 41/2018

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR. 9632, DATË 30.10.2006, "PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, 113, pika 1, shkronja "ç", 155 dhe 157, pika 3, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

"8. Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.".

Neni 2

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019.

Miratuar në datën 9.7.2018

Shpallur me dekretin nr. 10844, datë 26.7.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

LIGJ
Nr. 42/2018

PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË QËLLIMIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, PËR INSTALIMIN DHE PËRDORIMIN E SISTEMIT PËR KRAHASIMIN DHE VLERËSIMIN E SIGURT TË IDENTIFIKIMIT PERSONAL (PISCES)

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet memorandumi i qëllimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e Sistemit për Krahasimin dhe Vlerësimin e Sigurt të Identifikimit Personal (PISCES), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.7.2018

Shpallur me dekretin nr. 10845, datë 26.7.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MEMORANDUM QËLLIMI
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

Në njohje të dëshirës së qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të bashkëpunuar në luftën kundër terrorizmit;

për të forcuar më tej miqësinë dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre;

në përputhje me interesin e qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të mbështetur programe praktike për konsolidimin e aftësive të qeverisë së Republikës së Shqipërisë në luftën kundër terrorizmit;

bazuar në rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara, në veçanti UNSCR-së 1373 (2001) dhe 2178 (2014), si dhe në përputhje me marrëveshjen "Për shkëmbimin e informacionit për verifikimin e terrorizmit", ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës", nënshkruar më 26 prill 2016;

në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar të të dyja shteteve, duke respektuar privatësinë dhe të drejtat e liritë themelore,

qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës deklarojnë qëllimin e tyre, për të kryer sa më poshtë:

Neni 1

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës synon të kontribuojë, në varësi të disponueshmërisë së fondeve, duke mbështetur kapacitetet e autoriteteve të sigurisë që punojnë në pikat e hyrjes në Shqipëri, si më poshtë:

a) Sigurimin e Shqipërisë me Sistemin për Krahasimin dhe Vlerësimin e Sigurt të Identifikimit Personal (PISCES), për monitorimin e lëvizjes së udhëtarëve te pikat e hyrjes që do të përcaktohen bashkërisht nga të dyja qeveritë;

b) Instalimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike të këtij sistemi në pikat e hyrjes që do të përcaktohen bashkërisht nga të dyja qeveritë;

c) Trajnimin e personelit shqiptar për operimin dhe për mirëmbajtjen e këtij sistemi.

Neni 2

Me bashkëpunimin e qeverisë së Shqipërisë, qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës synon të instalojë dhe të mirëmbajë të gjitha pajisjet elektronike të nevojshme për sistemin PISCES, duke filluar në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, si dhe do të zgjerohet më pas në aeroporte dhe pikat kufitare të tjera të caktuara nga autoritetet e qeverisë së Shqipërisë, në bashkërendim me autoritetet e Shteteve të Bashkuara.

Neni 3

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës synon të kontribuojë në përgatitjen e infrastrukturës së ofruar nga qeveria e Shqipërisë, të nevojshme për instalimin dhe operimin e PISCES, në mënyrë të vazhdueshme. Sistemi do të plotësojë të gjitha funksionalitetet që i nevojiten Ministrisë së Brendshme.

Neni 4

Ministria e Brendshme e qeverisë së Shqipërisë synon të fillojë përzgjedhjen e personelit të qeverisë pritëse për të operuar dhe për të mirëmbajtur sistemin PISCES, me kusht që qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të ketë si qëllim trajnimin e këtij personeli për të krijuar një kuadër të kualifikuar për këtë sistem.

Neni 5

Ministria e Brendshme e qeverisë së Shqipërisë synon të përjashtojë nga taksa e TVSH-së dhe detyrimet doganore të gjitha mjetet dhe pajisjet kompjuterike që i përkasin sistemit PISCES dhe që importohen në dobi të qeverisë së Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Neni 6

Ministria e Brendshme e qeverisë së Shqipërisë dhe qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës synojnë të bashkërendojnë rishikime periodike në mënyrë që të inventarizohen dhe të përditësohen mjetet dhe pajisjet kompjuterike të siguruara nga Shtetet e Bashkuara për sistemin PISCES.

Neni 7

Ministria e Brendshme e qeverisë së Shqipërisë ka për qëllim të vendosë në punë, të administrojë dhe të mirëmbajë pajisjet e parashikuara për sistemin PISCES, posaçërisht për qëllimet e specifikuara këtu dhe në përputhje me të gjitha ligjet shqiptare që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale të garantuara për qytetarët e Republikës së Shqipërisë dhe shtetasit e huaj që vizitojnë Shqipërinë dhe me të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen me zbulimin dhe ndalimin e personave të kërkuar ndërkombëtarisht. Të dyja qeveritë synojnë të bashkërendohen përpara çdo transferimi apo zhvendosjeje të mjeteve dhe pajisjeve kompjuterike të PISCES.

Neni 8

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe qeveria e Shqipërisë synojnë të konsultohen në mënyrë periodike mbi zbatimin e këtij Memorandumi Qëllimi.

Neni 9

Me qëllim zbatimin e këtij Memorandumi Qëllimi, përfshi transmetimin dhe marrjen e çdo njoftimi, kërkese, dokumenti ose ndonjë komunikimi tjetër, pikat e kontaktit duhet të jenë:

Për qeverinë e Republikës së Shqipërisë: ministri i Brendshëm ose çdo person i caktuar nga ministri; dhe

Për qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës: Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri ose çdo person i caktuar nga ambasadori.

Neni 10

Ky Memorandum synohet të hyjë në fuqi në datën që nënshkruhet. Ky Memorandum ka për qëllim të vazhdojë të jetë në fuqi për një periudhë të pacaktuar kohe.

Neni 11

Secila qeveri duhet të përpiqet të sigurojë njoftim me shkrim mbi qëllimin e saj për ta përfunduar këtë Memorandum Qëllimi.

Nënshkruar në SHBA, më 22 mars 2018, në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike.

Për qeverinë e Republikës së Shqipërisë

Për qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

LIGJ
Nr. 43/2018

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË SPANJËS, PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETIT EVROPIAN, PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PAAUTORIZUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokolli ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.7.2018

Shpallur me dekretin nr. 10846, datë 26.7.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

PROTOKOLL
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË SPANJËS, PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETIT EVROPIAN, MBI RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PAAUTORIZUAR
(PROTOKOLLI I ZBATIMIT)

Palët e Protokollit të Zbatimit,

Republika e Shqipërisë dhe Mbretëria e Spanjës, më poshtë të referuara si "Palët Kontraktuese",

në përputhje me nenin 19 të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian mbi Ripranimin e Personave me Qëndrim të Paautorizuar (më poshtë e referuar si "Marrëveshja"), të nënshkruar në Bruksel, më 14 prill 2005,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Autoritetet kompetente

1. Në përputhje me dispozitat e nenit 1 dhe të nenit 19 të Marrëveshjes, Palët Kontraktuese kanë përcaktuar autoritetet kompetente të mëposhtme për zbatimin e saj.

- Pranimi, dorëzimi dhe trajtimi i kërkesave të ripranimit, tranzitit dhe shpenzimeve të tyre:

Për Republikën e Shqipërisë:
Ministria e Brendshme
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
Drejtoria e Migracionit
Tel./faks: 00355 4 22 26 932
E-mail: readmission@asp.gov.al

Për Mbretërinë e Spanjës:
Ministria e Brendshme
Drejtoria Kombëtare e Përgjithshme e Policisë
Komisariati i Përgjithshëm për të Huajt dhe Kufijtë
General Pardiñas, 90 dpdo. 28006 Madrid
Kërkesat për ripranim (orari zyrtar): nga e hëna deri të premten: 8:00–21:00.
Tel : +34 913226926 / +34 913226928
E-mail: cgef.ucfstc@policia.es

Kërkesa për tranzit (orari zyrtar): nga e hëna deri të premten: 8:00–21:00.
Tel: +34 913226929
E-mail: cged.0013@policia.es

Pas orarit zyrtar (kërkesa për ripranim dhe tranzit)
Tel : +34 913226839/40/41
E-mail: cged.0039@policia.es
Faks: +34 913226842/44

2. Për qëllimet e nenit 8(3) të Marrëveshjes, misionet kompetente diplomatike ose zyrat konsullore për kryerjen e intervistave të personave që do të ripranohen dhe për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit do të jenë:

Për Republikën e Shqipërisë:
Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Madrid
Calle Lagasca, 68, 1B,
28001 MADRID
Kingdom of Spain
Tel.: +34 91 562 6985
Fax: +34 91 561 3775

Për Mbretërinë e Spanjës:
Konsullata e Spanjës në Tiranë
Rruga "Skënderbej", nr. 43
1000, Tiranë
Republika e Shqipërisë
Tel.: +355 4 22 74 960, +355 4 2274 961
Faks: +355 4 22 25 383.

3. Palët kontraktuese informojnë njëra-tjetrën, pa vonesë, nëpërmjet kanaleve diplomatike dhe/ose në mënyrë të drejtpërdrejtë, për çdo ndryshim në listën e autoriteteve kompetente.

4. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese përcjellin me shkrim aplikimet, përgjigjet dhe njoftimet e parashikuara në Marrëveshje dhe në këtë Protokoll Zbatimi, duke përdorur mjetet teknike të komunikimit, kryesisht nëpërmjet *e-mail*-it.

Neni 2
Pikat e kalimit kufitar

1. Transferimi dhe tranzitimi i personave subjekt të këtij Protokolli Zbatimi do të ndodhë në pikat e mëposhtme të kalimit kufitar:

a) Për Republikën e Shqipërisë:
Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin, Tiranë
Komisariati për Kufirin dhe Migracionin, Rinas
Aeroporti Ndërkombëtar "Nënë Tereza"
E-mail: PKK.AeroportiRinas@ASP.gov.al; DRKM.Tiranë@ASP.gov.al
Tel./faks: 00355 4 23 64 028

b) Për Mbretërinë e Spanjës:
Adolfo Suárez - Madrid - Aeroporti Barajas International;
Barcelona - Aeroporti El Prat International; dhe
të gjitha aeroportet e tjera ndërkombëtare në territorin spanjoll.

Neni 3
Gjuha e komunikimeve

Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të përdorin gjuhën angleze për procedurat e kryera të parashikuara në Marrëveshje dhe Protokollin e Zbatimit.

Neni 4
Kërkesa për ripranim dhe kthimi i përgjigjes

1. Në përputhje me nenin 7(3) të Marrëveshjes, Autoriteti Kompetent i Palës kërkuese do të përdorë formularin e përbashkët të kërkesës për ripranim, bashkëlidhur si shtojca 5 e Marrëveshjes. Autoriteti kompetent i Palës së kërkuar duhet t'i kthejë përgjigje kërkesës për ripranim të autoritetit kompetent të Palës kërkuese, në përputhje me nenin 1(4) të këtij Protokolli Zbatimi.

2. Përgjigjja ndaj kërkesës për ripranim do të ketë shënimin që çdo fëmije duhet t'i lëshohet një dokument i veçantë udhëtimi, në rastin e ripranimit të fëmijëve së bashku me prindërit e tyre në territorin e Palës së Kërkuar.

3. Afatet kohore për kthimin e përgjigjes për kërkesën e ripranimit janë të përcaktuara në nenin 10(2) dhe (3) të Marrëveshjes.

4. Nëse janë plotësuar kushtet për ripranim, autoriteti kompetent i Palës së kërkuar duhet të njoftojë me shkrim për këtë autoritetin kompetent të Palës kërkuese, të përcaktuar në nenin 1 të këtij Protokolli Zbatimi, në përputhje me nenin 1(4) të këtij Protokolli Zbatimi.

5. Në rast të një përgjigjeje negative, autoriteti kompetent i Palës së kërkuar duhet të japë arsyet për refuzimin e ripranimit. Në këtë rast, mund të

paraqitet një aplikim i ri ripranimi për të njëjtin person, në rast se zbatohet një nga rrethanat e mëposhtme:

a) Paraqiten elemente të reja prove apo të dhëna *prima facie*;

b) Kërkohet një intervistë, në rast se nuk është kërkuar në aplikimin e parë.

Neni 5
Mjetet dhe dokumentet shtesë

1. Nëse autoriteti kompetent i Palës kërkuese konsideron se dokumente të tjera që nuk janë të renditura në shtojcat 1 dhe 4 të Marrëveshjes mund të jenë të rëndësishme për të përcaktuar shtetësinë e personit që pritet të ripranohet apo për të përcaktuar arsyet për ripranimin e shtetasve nga vende të treta apo pa shtetësi, dokumente të tilla mund t'i bashkëlidhen, gjithashtu, aplikimit të ripranimit që i dorëzohet autoritetit kompetent të Palës së kërkuar.

2. Vendimi nëse mund të merren në konsideratë dokumentet e përmendura në paragrafin 1, kur konsiderohet një kërkesë për ripranim, merret nga autoriteti kompetent i Palës së kërkuar.

3. Gjurmët e gishtave të paraqitura së bashku me kërkesën për ripranim duhet të përdoren, kur është e mundur, për të përcaktuar identitetin e personave që do të ripranohen dhe, rrjedhimisht, shtetësinë e tyre ose pajtueshmërinë me kushtet për ripranimin e shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi.

Neni 6
Intervistat

1. Në përputhje me nenin 8(3) të Marrëveshjes, me kërkesë të Palës kërkuese, nëse nuk mund të paraqitet asnjë nga dokumentet e renditura në shtojcën 1 apo 2 të Marrëveshjes, misioni kompetent diplomatik apo zyra konsullore e Palës së kërkuar duhet të intervistojë personin që do të ripranohet, në mënyrë që të përcaktohet kombësia e tij/e saj, brenda një periudhe maksimale prej tri ditësh pune nga data e kërkesës.

2. Kërkesat për intervistë duhet të shënohen në seksionin F të aplikimit për ripranim (shtojca 5 e Marrëveshjes).

3. Në rastet kur duhet të organizohet një intervistë, një kopje e aplikimit për ripranim duhet t'i dorëzohet nga Pala kërkuese misionit kompetent diplomatik ose zyrës konsullore të Palës së kërkuar, në territorin e Palës kërkuese.

4. Misioni diplomatik apo zyra konsullore e Palës së kërkuar informon autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese të përcaktuara në nenin 1(1) të këtij Protokolli Zbatimi, për rezultatin e intervistës.

5. Afatet kohore të parashikuara në nenin 10(2) dhe (3) të Marrëveshjes fillojnë nga momenti kur merret kërkesa për ripranim, pavarësisht nga momenti kur rezultati i intervistës bëhet i ditur.

Neni 7
Dokumentet e udhëtimit

1. Kur jepet pëlqimi për ripranim, autoriteti kompetent i Palës së kërkuar duhet t'i dorëzojë, gjithashtu, misionit kompetent diplomatik ose zyrës konsullore të Palës së kërkuar, përgjigjen pozitive të aplikimit për ripranim.

2. Pala kërkuese do t'i kërkojë lëshimin e dokumentit të udhëtimit misionit kompetent diplomatik apo zyrës konsullore të palës së kërkuar, nëse përgjigjja nuk është dhënë brenda limitit të kohës së përcaktuar.

3. Misioni diplomatik kompetent apo zyra konsullore e Palës së kërkuar lëshojnë dokumentin e udhëtimit, në përputhje me nenet 2(2), 3(3), 4(2) dhe 5(4) të Marrëveshjes, brenda 3 ditësh pune. Personi i cili do të ripranohet nuk ka nevojë të paraqesë aplikim.

Neni 8
Njoftimi për transferim

1. Bazuar në përgjigjen pozitive të kërkesës së ripranimit nga autoritetet kompetente të Palës së kërkuar, pas së cilës është lëshuar dokumenti përkatës i udhëtimit, në bazë të neneve 2(2), 3(3), 4(2) dhe 5(4) të Marrëveshjes, autoritetet kompetente të Palës kërkuese duhet të njoftojnë, në përputhje me nenin 1(1) të këtij Protokolli Zbatimi, autoritetin kompetent të Palës së kërkuar, për datën dhe të dhënat e fluturimit për transferimin, si dhe mbi përdorimin e eskortës, në rast se do të përdoret eskorta.

2. Njoftimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni duhet t'i dërgohen autoritetit kompetent të Palës së kërkuar, të paktën tri ditë kalendarike para kryerjes së transferimit.

3. Asnjë njoftim nuk është i nevojshëm për rastet e parashikuara në nenin 6(2) të marrëveshjes, kur nuk përdoret eskortimi.

Neni 9
Aplikimi për tranzit

1. Autoriteti kompetent i Palës kërkuese duhet t'i drejtohet autoritetit kompetent të Palës së kërkuar, duke dorëzuar kërkesën për tranzitin e shtetasve të vendeve të treta apo personave pa shtetësi, nëpërmjet territorit të Palës së kërkuar, në përputhje me nenin 14 të Marrëveshjes, duke përdorur shtojcën 6 të Marrëveshjes.

2. Tranzitet duhet të ndodhin vetëm me rrugë ajrore dhe brenda të njëjtit aeroport.

3. Një kërkesë për tranzit duhet t'i dorëzohet pa vonesë, por të paktën 5 ditë kalendarike para tranzitit të planifikuar, autoritetit kompetent të Palës së kërkuar.

4. Autoriteti kompetent i Palës së kërkuar duhet të kthejë përgjigje pa vonesë, por jo më vonë se 5 ditë kalendarike pas marrjes së kërkesës për tranzit, duke deklaruar nëse e pranon tranzitin dhe kohën për të cilën është planifikuar dhe përdorimin eventual të eskortës.

5. Afate kohore më të shkurtra mund të bihen dakord ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese, në raste të veçanta.

6. Në rast të një përgjigjeje negative, autoriteti kompetent i Palës së kërkuar duhet të japë arsyet për refuzimin e tranzitit.

7. Nëse Autoriteti Kompetent i Palës Kërkuese nuk ka specifikuar në aplikimin për tranzit datën e saktë, të dhënat e fluturimit ose të dhëna të tjera të rëndësishme, duhet të dorëzohet një njoftim tjetër mbi tranzitin e shtetasve të vendeve të treta apo personave pa shtetësi për të cilët autoriteti kompetent i palës së kërkuar ka dhënë pëlqim paraprak.

Neni 10
Eskortimi

1. Nëse ripranimi ose tranziti kryhet me eskortë, oficerët e eskortës duhet të kryejnë detyrat e tyre të paarmatosur, të jenë të veshur civilë dhe të kenë me vete pasaportë të vlefshme dhe dokumente që konfirmojnë kushtet e ripranimit apo të tranzitit.

2. Në rastet e tranzitit me rrugë ajrore, autoriteti kompetent i Palës së kërkuar mund të sigurojë, nëse është e nevojshme, mbikëqyrjen dhe imbarkimin e të kthyerit, në marrëveshje me oficerët e shoqërimit.

3. Pala e kërkuar duhet t'u ofrojë të njëjtën mbrojtje dhe asistencë oficerëve të policisë së Palës Kërkuese, në ushtrim të detyrave të tyre, në kuadër të këtij Protokolli, të cilat gëzohen nga oficerët e tyre të policisë që kryejnë detyra të ngjashme.

4. Mbikëqyrja dhe imbarkimi i personave të pashoqëruar në tranzit ajror duhet të sigurohet nga oficerët e policisë së Palës së Kërkuar, në bazë të kërkesës paraprake me shkrim në kreun C (vërejtje) të aplikimit për tranzit dhe konfirmimit nga autoriteti kompetent i Palës së kërkuar. Gjithashtu, autoriteti kompetent i Palës së kërkuar mund të marrë masa me iniciativë të vet.

Neni 11
Monitorimi

Në operacionet e kthimit që ndërmerren nga pala kërkuese, për transferimet ose tranzitet që kryhen në zbatim të Marrëveshjes, duhet të lejohen organet kombëtare dhe ndërkombëtare monitoruese, të vëzhgojnë fazën e operacionit që kryhet në territorin e palës së kërkuar, duke përfshirë edhe dorëzimin e mundshëm të të kthyerve tek autoritetet e tyre, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Neni 12
Shpenzimet

1. Shpenzimet për ripranim përfshijnë:

- shpenzimet e transportit deri në pikat e kalimit kufitar të përcaktuara në nenin 2 të këtij Protokolli Zbatimi;
- shpenzimet e eskortës të personave që eskortohen për arsye sigurie.

2. Shpenzimet e përmendura në paragrafët e mësipërm mbulohen në euro nga Pala kërkuese, siç është parashikuar në nenin 15 të Marrëveshjes.

3. Secila Palë Kontraktuese mbulon shpenzimet për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit për shtetasit e saj, sipas neneve 2(2) dhe 4(2) të Marrëveshjes.

Neni 13
Hyrja në fuqi, përfundimi dhe amendimet

1. Protokolli i Zbatimit do të hyjë në fuqi tri ditë pasi Komiteti i Përbashkët i Ripranimit merr njoftimin për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore të shteteve respektive, të nevojshme për këtë qëllim, në përputhje me nenin

19(2) të Marrëveshjes. Njoftimi duhet të dërgohet nga pala kontraktuese spanjolle menjëherë pasi palët kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për këtë qëllim.

2. Ky Protokoll Zbatimi do të pushojë së zbatuari në të njëjtën kohë me Marrëveshjen.

3. Palët Kontraktuese mund të amendojnë këtë Protokoll Zbatimi me miratim të ndërsjellë. Amendimet do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurën e përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Secila palë mund ta përfundojë këtë protokoll në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim 6 muaj përpara palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Përfundimi i protokollit duhet t'i njoftohet Komitetit të Përbashkët të Ripranimeve.

Nënshkruar në Tiranë, më 5 prill 2018, në dy tekste origjinale në secilën prej gjuhëve të Palëve dhe në gjuhën angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast të mosmarrëveshjeve për interpretimin e këtij Protokolli Zbatimi, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
Rovena Voda
Zëvendësministre e Brendshme

PËR MBRETËRINË E SPANJËS
Vicente Canelles Montero
Ambasador i Mbretërisë së Spanjës në Republikën e Shqipërisë

LIGJ
Nr. 44/2018

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME VENDIN PRITËS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja me vendin pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 19.7.2018

Shpallur me dekretin nr. 10847, datë 26.7.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE
ME VENDIN PRITËS NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
FONDIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Republika e Shqipërisë, në vijim e referuar si "Vendi Pritës" dhe Fondi i Ballkanit Perëndimor, në vijim i referuar si "Fondi", të dyja së bashku të referuara si "Palët",

duke iu referuar "Marrëveshjes për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor", të nënshkruar në Pragë, më 13 nëntor 2015;

duke vërejtur se Marrëveshja parashikon krijimin e Selisë së Fondit të Ballkanit Perëndimor në Tiranë, Republika e Shqipërisë;

duke dëshiruar rregullimin e privilegjeve dhe imuniteteve të nevojshme për funksionimin dhe përmbushjen e suksesshme të misionit të Fondit,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni l
Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

a) "Palë Kontraktuese" nënkupton një Palë Kontraktuese të Marrëveshjes për Themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor";

b) "Fond" nënkupton Fondin e Ballkanit Perëndimor;

c) "Sekretariat" nënkupton Sekretariatin e Fondit;

d) "Drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor ekzekutiv" nënkupton një person të emëruar si drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor ekzekutiv të Fondit;

e) "Personel ndërkombëtar" nënkupton një anëtar të personelit të Sekretariatit, me kusht që të mos jenë shtetas të vendit pritës dhe as shtetas

i huaj me vendbanim të përhershëm në vendin pritës;

f) "Personel i rekrutuar në vend" nënkupton një anëtar të personelit të Sekretariatit, i cili është shtetas i vendit pritës ose shtetas i huaj me vendbanim të përhershëm në vendin pritës;

g) "Anëtar i familjes" nënkupton një bashkëshort, fëmijë të pamartuar deri në moshën 18 vjeç dhe midis 18 dhe 23 vjeç, me kusht që ata të ndjekin studimet e plota akademike në vendin pritës, persona me aftësi të kufizuara nën kujdesin e anëtarit të stafit ndërkombëtar, me kusht që të jetojnë në vendin pritës në të njëjtën shtëpi me drejtorin ekzekutiv, zëvendësdrejtorin ekzekutiv, përfaqësuesin dhe një anëtar të personelit ndërkombëtar dhe se ata nuk janë shtetas të vendit pritës ose shtetas të huaj me vendbanim të përhershëm në vendin pritës;

h) "Ekspert i kontraktuar" nënkupton një person që kryen një mision të përkohshëm për Fondin, i kontraktuar nga ky i fundit;

i) "Përfaqësues" nënkupton një zyrtar të caktuar apo të dërguar nga një prej Palëve Kontraktuese pranë Fondit;

j) "Ambiente të Fondit" nënkupton objektet, duke përfshirë tokën ndihmëse të tyre, të zëna nga Fondi dhe të përdorura vetëm për qëllimet e Fondit.

Neni 2
Selia e Fondit

Selia e Fondit ndodhet në Tiranë, kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë. Vendi pritës do t'i sigurojë Fondit, pa pagesë, objektet e nevojshme dhe hapësirat e duhura, si dhe pajisje, orendi për përmbushjen efektive të funksioneve të saj për pesë vitet e para pas themelimit të Fondit.

Neni 3
Personaliteti juridik

Fondi, i themeluar si një organizatë ndër-kombëtare, gëzon personalitet të plotë juridik sipas ligjit shqiptar dhe ka aftësi juridike për të përmbushur funksionet e veta për të lidhur kontrata, për të blerë dhe për të shitur prona të luajtshme dhe të paluajtshme, si edhe për të vendosur dhe për të ndjekur procedurat ligjore.

Neni 4
Logoja dhe përcaktimet

1. Fondi mund të shpalosë flamurin, logon dhe simbolet e tjera në mjediset e tij dhe në mjetet motorike të Fondit.

2. Mjetet motorike të Fondit kanë të drejtën e regjistrimit diplomatik dhe statusin përkatës sipas legjislacionit të vendit pritës.

Neni 5
Imunitetet dhe privilegjet

1. Fondi do të gëzojë imunitete dhe privilegje të garantuara për të gjitha misionet diplomatike të akredituara në vendin pritës.

2. Ambientet e Fondit janë të pacenueshme.

3. Shteti pritës do të garantojë që selia e Fondit të jetë e pacenueshme. Autoritetet kompetente të vendit pritës kanë të drejtë të hyjnë në ambientet e Fondit për të kryer detyrat e tyre vetëm me pëlqimin e drejtorit ekzekutiv të Sekretariatit ose një zyrtari të autorizuar të Sekretariatit. Megjithatë, në rast zjarri ose emergjence të ngjashme, një pëlqim i tillë konsiderohet se është dhënë nëse nevojiten masa mbrojtëse të menjëhershme.

4. Dokumentet dhe materialet arkivore të Fondit, duke përfshirë të gjitha aplikacionet kompjuterike dhe dosjet digjitale që i përkasin atij ose në zotërim të tij, janë të paprekshme.

5. Importi dhe eksporti i botimeve, si dhe i materialeve informative për përdorim nga Fondi, përjashtohen nga të gjitha tatimet dhe taksat.

6. Fondi, asetet, të ardhurat dhe pasuri të tjera të tij përjashtohen nga taksat e drejtpërdrejta kombëtare dhe vendore. Ky përjashtim nuk zbatohet për tatimet dhe fondet e caktuara për një qëllim që konsiderohen si tarifa për shërbimet komunale të ofruara sipas normave të përcaktuara, sipas sasisë së shërbimeve të ofruara, të cilat mund të identifikohen, përshkruhen dhe ndahen.

7. Fondi ka të drejtë të importojë sasi të arsyeshme mallrash pa detyrim tatimor dhe doganor për përdorim zyrtar të tij, duke përfshirë edhe automjetet zyrtare.

8. Për sa i përket tatimit mbi vlerën e shtuar të përfshirë në çmime ose të faturuara veçmas, përjashtimi do të zbatohet vetëm për sasitë e arsyeshme të artikujve të blerë dhe shërbimeve të bëra për përdorim zyrtar nga Sekretariati, rast në

të cilin mallrat e blera për përdorim prej tij, në lidhje me të cilat zbatohen përjashtimet në përputhje me këtë dispozitë, nuk mund të shiten, jepen ose asgjësohen në ndonjë mënyrë tjetër, përveç në kushtet e rëna dakord me qeverinë e vendit pritës.

9. Qeveria e vendit pritës ndërmerr të gjitha masat për të mbrojtur ambientet e Fondit nga çdo ndërhyrje ose dëmtim, cenim ose shkelje e dinjitetit të Fondit.

Neni 6
Disponimi i fondeve

Për qëllime të ushtrimit të funksioneve të tij, Fondi ka të drejtë të marrë, mbajë, shkëmbejë, transferojë të gjitha fondet, monedhat, paratë e gatshme dhe t'i shpërndajë lirisht ato, në përputhje me rregullat e vendit pritës nën të njëjtat kushte si për misionet diplomatike.

Neni 7
Kontributet individuale për Fondin

Kontributet e bëra nga individët dhe subjektet private për Fondin nuk janë subjekt i imuniteteve dhe privilegjeve diplomatike.

Neni 8
Sigurimet shoqërore

1. Drejtori ekzekutiv, zëvendësdrejtori ekzekutiv, përfaqësuesit dhe personeli ndërkombëtar përjashtohen nga pagesa e kontributeve të detyrueshme në lidhje me çdo lloj sigurimi shoqëror në vendin pritës.

2. Personeli i rekrutuar në nivel vendor u nënshtrohet të gjitha kontributeve të detyrueshme, në përputhje me legjislacionin e vendit pritës.

Neni 9
Drejtori ekzekutiv dhe zëvendësdrejtori ekzekutiv i Fondit

1. Gjatë mandatit të detyrës së tij në vendin pritës, drejtori ekzekutiv dhe zëvendësdrejtori ekzekutiv i Fondit gëzojnë imunitete dhe privilegje të dhëna për drejtuesit e zyrave të ngjashme të organizatave ndërkombëtare në vendin pritës, të parashikuara në nenin 10 më poshtë.

Neni 10
Imunitetet dhe privilegjet e personelit ndërkombëtar

Gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre zyrtare në territorin e vendit pritës, personeli ndërkombëtar dhe familjarët e tyre mbajtës të pasaportave zyrtare, përveç nëse janë shtetas të vendit pritës ose shtetas të huaj me vendbanim të përhershëm në vendin pritës, gëzojnë imunitetet dhe privilegjet e mëposhtme në vendin pritës:

a) Imunitet nga juridiksioni penal i vendit pritës në lidhje me të gjitha veprimet e kryera nga ai/ajo në funksionin zyrtar të tij/saj, duke përfshirë fjalët e folura ose të shkruara;

b) Imunitet nga juridiksioni civil dhe administrativ, përveç kur bëhet fjalë:

1. Për një veprim real lidhur me një ndërtesë private që ndodhet në territorin e vendit pritës, përveç kur ai e posedon atë për llogari të Fondit dhe për qëllimet e misionit;

2. Për një veprim lidhur me një trashëgimi, në të cilën personeli ndërkombëtar figuron si zbatues i testamentit, administrator, trashëgimtar, si privat dhe jo në emër të Fondit;

3. Për një veprim lidhur me një profesion të lirë ose me një aktivitet tregtar çfarëdoqoftë, të ushtruar nga personeli ndërkombëtar në vendin pritës jashtë funksioneve të tij zyrtare;

c) Paprekshmërinë e të gjitha dokumenteve zyrtare;

d) Paprekshmërinë e bagazhit të tij/saj zyrtar;

e) Paprekshmërinë e bagazhit të tij/saj personal;

f) Përjashtimin në lidhje me të gjitha taksat e drejtpërdrejta dhe të njëjtat privilegje në lidhje me lehtësirat e shkëmbimit që i akordohen personelit diplomatik.

Neni 11
Privilegjet e përfaqësuesve

Gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre përfaqësuesit e caktuar apo të dërguar nga një prej Palëve Kontraktuese pranë Fondit, të cilët nuk janë mbajtës të pasaportave zyrtare gazojnë privilegjet e mëposhtme:

a) Përjashtimin në lidhje me të dhe anëtarët e familjes së tij/saj që përbëjnë pjesë të familjes së tij/saj nga kufizimet e emigracionit dhe regjistrimi i të huajve;

b) Të drejtën për të importuar pa doganë orenditë dhe sendet personale të tij/saj në kohën e fillimit të funksionit të tij/saj dhe rieksportimin e tyre pa doganë;

c) Të drejtën për të importuar automjetin e vet privat për përdorimin personal të tij/saj dhe më pas për rieksportimin e këtij automjeti pa doganë.

Neni 12
Personeli i rekrutuar në nivel vendor

1. Personeli i rekrutuar në nivel vendor punësohet në përputhje me legjislacionin në fuqi të vendit pritës.

2. Personeli i rekrutuar në nivel vendor, në bazë të kësaj Marrëveshjeje, gëzon vetëm imunitetin nga juridiksioni për veprimet e kryera prej tyre gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre, duke përfshirë fjalët e folura ose të shkruara, në detyrën e tyre zyrtare.

Neni 13
Eksperti i kontraktuar

Gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre zyrtare në territorin e vendit pritës, ekspertët, përveç nëse janë shtetas të vendit pritës ose shtetas të huaj me vendbanim të përhershëm në vendin pritës, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

a) Imunitetin nga juridiksioni për veprimet e kryera prej tyre gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre, duke përfshirë fjalët e folura ose të shkruara, në detyrën e tyre zyrtare;

b) Paprekshmërinë e të gjitha letrave zyrtare, të dhënave të mediave dhe dokumenteve, në përputhje me procedurat standarde;

c) Përjashtimin nga kufizimet e emigracionit në përputhje me rregullat e vendit pritës.

Neni 14
Përjashtimi nga imuniteti

Pa cenuar privilegjet dhe imunitetet e tyre, është detyrë e të gjithë personave që gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e parashikuara në këtë marrëveshje, të respektojnë ligjet dhe rregulloret e vendit pritës.

Neni 15
Heqja dorë nga imuniteti

1. Privilegjet dhe imunitetet e parashikuara në këtë Marrëveshje nuk jepen për përfitime personale të zyrtarëve të Fondit që i gëzojnë ato, por për të garantuar ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre.

2. Në bazë të kërkesës me shkrim të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të vendit pritës për Sekretariatin e Fondit, Këshilli i Zyrtarëve të Lartë do të heqë imunitetin e çdo zyrtari të Sekretariatit, në çdo rast kur sipas mendimit të tij, imuniteti do të pengonte rrjedhën e drejtësisë dhe mund të hiqet pa cenuar interesin e Fondit. Heqja e imunitetit nga juridiksioni duhet të shprehet gjithmonë me shkrim.

3. Heqja e imunitetit nga juridiksioni në lidhje me procedurat administrative nuk do të konsiderohet për të nënkuptuar heqjen e imunitetit në lidhje me ekzekutimin e vendimit, për të cilin është e nevojshme një heqje dorë e veçantë.

Neni 16
Njoftimet

Sekretariati i Fondit i siguron Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të vendit pritës:

a) Listën e përfaqësuesve, personelit ndërkombëtar dhe anëtarëve të familjeve të tyre që janë pjesë e familjeve të tyre përkatëse, menjëherë ose maksimumi brenda tri ditëve nga data e mbërritjes së tyre;

b) Gjithashtu, Sekretariati i Fondit do të japë njoftim për skadimin e mandatit të çdo përfaqësuesi dhe personelit ndërkombëtar të njoftuar në përputhje me paragrafin "a" dhe, siç mund të jetë e nevojshme, që një person pushon të qeni anëtar familjeje i familjeve të tyre përkatëse.

c) Përfaqësuesit dhe personeli ndërkombëtar të njoftuar në përputhje me paragrafin e mësipërm dhe anëtarët e familjeve së tyre që janë pjesë e familjeve të tyre përkatëse, mbajtës të pasaportave zyrtare, pajisen me dokumentet e identifikimit të lëshuara nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të vendit pritës, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 17
Përgjegjësia e vendit pritës

Vendi pritës nuk konsiderohet përgjegjës për veprimet ose mosveprimet e kryera nga Sekretariati dhe personeli i tij brenda territorit të tij.

Neni 18
Çështje të sigurisë

1. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk përjashton të drejtën e qeverisë së vendit pritës për të marrë të gjitha masat përkatëse të mbrojtjes në interes të sigurisë publike ose për të penguar zbatimin e ligjeve të vendit pritës, të cilat janë të nevojshme për ruajtjen e shëndetit dhe rendit publik.

2. Nëse qeveria e vendit pritës merr në konsideratë, se zbatimi i dispozitave të përmendura në paragrafin 1 më sipër është i nevojshëm, sapo ta lejojnë rrethanat, ajo kontakton Sekretariatin në mënyrë që të marrë një vendim të përbashkët për masat që mund të jenë të nevojshme për mbrojtjen e interesave të Fondit.

3. Sekretariati është i detyruar të bashkëpunojë me autoritetet e vendit pritës, në mënyrë që të shmangë çdo dëm të sigurisë publike që rezulton nga ndonjë veprimtari e Fondit.

Neni 19
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhen nëpërmjet bisedimeve ndërmjet Palëve.

2. Autoriteti kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të natyrës private ndërmjet Fondit dhe entiteteve private dhe individëve do të jetë gjykata ku Fondi ka selinë e tij.

Neni 20
Ndryshimet

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve. Ndryshimet hyjnë në fuqi në përputhje me nenin 21 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 21
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit të Sekretariatit nga Republika e Shqipërisë se janë plotësuar të gjitha kërkesat e nevojshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Një kopje e këtij njoftimi u dërgohet të gjitha Palëve Kontraktuese të Ballkanit Perëndimor.

Neni 22
Përfundimi

Kjo marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhe të pacaktuar.

Secila palë mund ta përfundojë këtë Marrëveshje në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Ky përfundim do të hyjë në fuqi 6 (gjashtë) muaj pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Pala tjetër.

Neni 23
Depozitari

Qeveria e Republikës së Shqipërisë vepron si depozitar i kësaj Marrëveshjeje.

Origjinali i kësaj Marrëveshjeje depozitohet pranë depozitarit, i cili i dërgon një kopje të vërtetuar fondit dhe të gjitha Palëve Kontraktuese të Ballkanit Perëndimor.

Nënshkruar në ....., më ....., në dy origjinale në gjuhën angleze.

Për
Republikën e Shqipërisë

Për
Fondin e Ballkanit Perëndimor

LIGJ
Nr. 45/2018

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË NDRYSHIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DUKE VEPRUAR NËPËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE, DHE TRANS ADRIATIC PIPELINE AG, LIDHUR ME MARRËVESHJEN ME QEVERINË E VENDIT PRITËS

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar

nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 19.7.2018

Shpallur me dekretin nr. 10848, datë 26.7.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJA E NDRYSHIMIT
DATË 8 QERSHOR 2018
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
DUKE VEPRUAR NËPËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE DHE TRANS ADRIATIC PIPELINE AG, NË LIDHJE ME MARRËVESHJEN E QEVERISË PRITËSE, TË DATËS 5 PRILL 2013

Kjo marrëveshje lidhet në datën 8 qershor 2018 ndërmjet:

1. Republikës së Shqipërisë që vepron nëpërmjet Këshillit të Ministrave (Shteti); dhe

2. Trans Adriatic Pipeline AG, një shoqëri e organizuar dhe që ekziston në bazë të ligjeve të Zvicrës, me degë të regjistruar në Shqipëri, në adresën: Qendra e Biznesit ABA, zyra nr. 906, rruga "Papa Gjon Pali II", 1010 Tiranë; regjistruar në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Tiranë, me nr. regjistrimi: K92402023O (Investitori i Projektit dhe së bashku me Shtetin, Palët).

HYRJE

A) Gjatë vitit 2012, Palët hynë në bisedime për një marrëveshje me Qeverinë Pritëse, në lidhje me gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti). Marrëveshja me Qeverinë Pritëse (MQP) u lidh nga Palët më 5 prill 2013 dhe më pas u paraqit për ratifikim nga Parlamenti Shqiptar, më 15 prill 2013.

B) Më 1 mars 2017, Palët hynë në një marrëveshje ndryshimi që parashikon disa ndryshime në kushtet e MQP-së.

C) Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të përfshijë në MQP dispozita që rregullojnë trajtimin e TVSH-së në lidhje me aktivitetet e ndërtimit gjatë Fazës së Ndërtimit të Projektit, veçanërisht për të përfshirë zbatimin e skemës së autofaturimit për TVSH-në e shkaktuar nga Investitori i Projektit dhe Kontraktuesit në lidhje me furnizimin e mallrave dhe të shërbimeve.

D) Synohet që kjo Marrëveshje të ratifikohet nga Parlamenti Shqiptar.

Kjo Marrëveshje është plotësuese dhe ndryshon MQP-në.

Palët bien dakord si më poshtë:

1. INTERPRETIMI

1.1 Përkufizimet

Në këtë Marrëveshje:

"MQP e ndryshuar" nënkupton MQP-në e ndryshuar nga kjo Marrëveshje.

"Data e Hyrjes në Fuqi" ka kuptimin e dhënë në nenin 2, "Data e Hyrjes në Fuqi".

"Autorizim i Ndihmës Shtetërore" do të thotë vendimi i autoritetit përkatës, duke përfshirë Komisionin Shqiptar të Ndihmës Shtetërore, si dhe çdo autoritet tjetër kombëtar ose evropian se ndryshimet që do të bëhen nga kjo Marrëveshje në MQP dhe detyrimet e Shtetit sipas MQP-së së ndryshuar, nuk përbëjnë ndihmë shtetërore të paligjshme sipas kuptimit të ligjit shqiptar ose të nenit 18(1)(c) të Traktatit të Komunitetit të Energjisë ose që, në rast se këto masa përbëjnë ndihmë shtetërore, kjo ndihmë është në përputhje me ligjin shqiptar ose Traktatin e Komunitetit të Energjisë.

1.2 Interpretimi

a) Termat me germa të mëdha të përkufizuar në MQP kanë kuptim të njëjtë në këtë Marrëveshje, përveç nëse në të parashikohet ndryshe.

b) Dispozitat e neneve 1.3, "Ndërtimi"; 34, "Përgjegjësia ndaj Palëve të Treta"; 36, "Heqja dorë nga Imuniteti"; 37, "Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve" dhe 38, "Ligji i zbatueshëm" i MQP-së, zbatohen edhe për këtë Marrëveshje, sikur të ishin përcaktuar plotësisht në këtë Marrëveshje, përveçse referencat në MQP duhet të konsiderohen si referenca në këtë Marrëveshje.

2. DATA E HYRJES NË FUQI

2.1 Pa cenuar dispozitat e nenit 2.6, Data e Hyrjes në Fuqi të kësaj Marrëveshjeje është subjekt i:

a) Nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga përfaqësuesit e autorizuar të Palëve;

b) Miratimit të mëtejshëm të kësaj Marrëveshjeje nga Këshilli i Ministrave të Shtetit;

c) Botimit në Fletoren Zyrtare të ligjit të Parlamentit të Shtetit që ratifikon këtë Marrëveshje;

d) Marrjes së Autorizimit të Ndihmës Shtetërore; dhe

e) Datës së Hyrjes në Fuqi, në përputhje me nenin 2.2.

2.2 Nëse secila nga Palët çmon se të gjitha kushtet paraprake të përcaktuara në nenin 2.1 (përveç kushtit paraprak të përcaktuar në nenin 2.1(e) janë plotësuar, duhet të njoftojë Palën tjetër. Nëse Pala tjetër bie dakord se të gjitha kushtet paraprake të përcaktuara në nenin 2.1 (përveç kushtit paraprak të përcaktuar në nenin 2.1(e) janë plotësuar, duhet të njoftojë me shkrim Palën e parë, data e këtij njoftimi do të jetë Data e Hyrjes në Fuqi. Pa cenuar dispozitat e nenit 2.6, në Datën e Hyrjes në Fuqi kjo Marrëveshje do të bëhet efektive dhe do të hyjë në fuqi.

2.3 Menjëherë pas datës së kësaj Marrëveshjeje, Shteti duhet:

a) Të paraqesë këtë Marrëveshje pranë Parlamentit të Shtetit për ratifikim dhe/ose miratim, në mënyrë që kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi sipas Kushtetutës, si pjesë e ligjit shqiptar;

b) Të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të paraqitur drafte të legjislacionit lejues dhe të ligjeve të tjera sipas nevojës, për të lidhur këtë Marrëveshje dhe, në veçanti të drejta, garanci, përjashtime, grante, privilegje, standarde, përjashtime dhe dëmshpërblime mbi përgjegjësinë ligjore të zbatueshme për Projektin dhe efektive sipas Kushtetutës ose ligjit shqiptar;

c) Të bëjë përpjekje për të siguruar marrjen e ratifikimeve dhe/ose të miratimeve të kësaj Marrëveshjeje, si dhe zbatimin e këtij legjislacioni përpara ose së bashku me ratifikimin dhe/ose miratimin; dhe

d) Të bëjë përpjekje për marrjen e Autorizimit të Ndihmës Shtetërore.

2.4 Nëse pavarësisht përpjekjeve të Shtetit, autoriteti kompetent, duke përfshirë Komisionin shqiptar të Ndihmës Shtetërore ose çdo autoritet tjetër kompetent kombëtar ose evropian, jep Autorizimin e Ndihmës Shtetërore me kusht që kësaj Marrëveshjeje t'i bëhen ndryshime ose kushte të tjera, vendimi i autoritetit përkatës do të konsiderohet si Autorizim i Ndihmës Shtetërorë, për qëllim të kësaj Marrëveshjeje, nëse këto ndryshime ose kushte pranohen me shkrim nga Investitori i Projektit.

2.5 Shteti duhet që herë pas here dhe, me kërkesë të Investitorit të Projektit, t'u përgjigjet me shkrim pyetjeve të Investitorit të Projektit mbi progresin e Shtetit, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve sipas nenit 2.3.

2.6 Pavarësisht se kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në Datën e Hyrjes në Fuqi, nenet 2, "Data e Hyrjes në Fuqi"; 4, "Përfaqësime dhe Garanci", 5, "Të ndryshme" dhe 6, "Ligji i zbatueshëm", do të bëhen efektive dhe do të fillojnë në datën e kësaj Marrëveshjeje.

3 NDRYSHIMET

a) MQP-ja ndryshohet nga Data e Hyrjes në Fuqi në mënyrën e përcaktuar në shtojcën 1, "Ndryshime në Marrëveshjen me Qeverinë Pritëse".

b) Ministria e Financave duhet të hartojë një udhëzim mbi zbatimin e drejtë të ndryshimeve të përcaktuara në shtojcën 1 nga autoritetet tatimore dhe doganore.

4. PËRFAQËSIME DHE GARANCI

4.1 Përfaqësime dhe Garanci të Shtetit

Shteti kryen përfaqësimet dhe garancitë e përcaktuara, në:

a) Paragrafët "b" dhe "d", të nenit 12.1, "Përfaqësime dhe Garanci të Shtetit", të MQP-së mbi Datën e Hyrjes në Fuqi; dhe

b) Paragrafët "a" dhe "e" të nenit 12.1, mbi Datën e Hyrjes në Fuqi dhe përsërit ato përfaqësime dhe garanci në secilën datë të mëpasshme,

në secilin rast, duke iu referuar fakteve dhe rrethanave që do të ekzistojnë në atë moment, si dhe referimi te MQP-ja është referim në këtë Marrëveshje dhe MQP-në e Ndryshuar.

4.2 Përfaqësime dhe Garanci të Investitorit të Projektit

Investitori i Projektit kryen përfaqësimet dhe garancitë e përcaktuara, në:

a) Paragrafët "a" dhe "c" të nenit 13.1, "Përfaqësime dhe Garanci të Investitorit të Projektit", të MQP-së mbi Datën e Hyrjes në Fuqi; dhe

b) Paragrafët "b" dhe "d", të nenit 13.1, mbi Datën e Hyrjes në Fuqi dhe përsërit ato përfaqësime dhe garanci në secilën datë të mëpasshme,

në secilin rast duke iu referuar fakteve dhe rrethanave që do të ekzistojnë në atë moment, si dhe referimi te MQP-ja është referim në këtë Marrëveshje dhe MQP-në e Ndryshuar.

5. TË NDRYSHME

Në bazë të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, MQP-ja do të mbetet në fuqi dhe efekt të plotë.

6. LIGJI RREGULLUES

Kjo Marrëveshje dhe detyrimet jashtë-kontraktuale që lindin nga ose në lidhje me të, rregullohen nga ligji anglez.

Kjo Marrëveshje është lidhur në datën e caktuar në fillim të kësaj Marrëveshjeje.

SHTOJCA 1
NDRYSHIMET NË MARRËVESHJEN ME QEVERINË PRITËSE

MQP-ja do të ndryshohet si më poshtë:

1. Fjalët "Marrëveshja e Ndryshimit" fshihen nga parathënia H dhe zëvendësohen me fjalët "Marrëveshja e Parë e Ndryshimit". Çdo paraqitje e mëvonshme e termit të përkufizuar "Marrëveshja e Ndryshimit", në atë parathënie dhe në nenin 2.7, fshihet dhe zëvendësohet me fjalët "Marrëveshja e Parë e Ndryshimit".

2. Shtohet një parathënie e re I, si më poshtë:

"I) Më 8 qershor 2018, Palët kanë lidhur një marrëveshje ndryshimi (Marrëveshja e Dytë e Ndryshimit) që përmban disa ndryshime në kushtet e kësaj Marrëveshjeje. Marrëveshja e Dytë e Ndryshimit ka hyrë në fuqi dhe ka efekt pas plotësimit të kushteve të mbuluara në nenin 2, "Data e Hyrjes në Fuqi" të kësaj Marrëveshjeje.".

3. Përkufizimet e mëposhtme i shtohen nenit 1.1, "Përkufizimet":

"i. Kontraktuesi i Nivelit të Parë nënkupton çdo person dhe filialet e tij që furnizojnë mallra dhe/ose shërbime për Investitorin e Projektit, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me kontratë, nënkontratë ose në ndonjë mënyrë tjetër të përcaktuar në legjislacionin shqiptar, por duke përjashtuar çdo individ që vepron në rolin e tij ose të saj si punonjës i ndonjë personi tjetër;

ii. Kontraktuesi i Nivelit të Dytë do të thotë çdo person me të cilin Kontraktuesi ka një marrëveshje për të kryer detyra specifike në ofrimin e furnizimit të mallrave dhe/ose shërbimeve për Investitorin e Projektit;

iii. lista e Kontraktuesve ka kuptimin e dhënë në nenin 24.15(d)(iv).".

4. Një nen i ri 2.8 shtohet si më poshtë:

"2.8 Palët pranojnë që, pa cenuar nenin 3.4(b), në Datën e Hyrjes në Fuqi (sipas dhe siç përcaktohet në Marrëveshjen e Dytë të Ndryshimit), kjo Marrëveshje e ndryshuar me Marrëveshjen e Dytë të Ndryshimit është plotësisht efektive sipas Kushtetutës si legjislacion shqiptar.".

5. Neni i paraqitur më poshtë është përfshirë si neni 24.15 i MQP-së dhe nenet e tjera të përcaktuara në nenin 24, "Taksat" (dhe çdo referencë në MQP ndaj atyre neneve) rinumërtohen:

"24.15 Pa cenuar pjesën e mbetur të këtij neni 24, trajtimi i TVSH-së në lidhje me aktivitetet e ndërtimit gjatë Fazës së Ndërtimit të Projektit do të jetë si vijon:

a) Në lidhje me importimin e mallrave nga Investitori i Projektit ose Kontraktuesi i Nivelit të Parë, importuesi nuk do të ketë detyrim për pagesën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar pranë autoriteteve doganore që duhej kryer, në lidhje me këto importe. Ky import mallrash do të trajtohet si një furnizim mallrash i kryer nga importuesi për veten e tij, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike, me efekt lindjen e detyrimit të importuesit për të paguar këtë tatim mbi vlerën e shtuar ndaj administratës tatimore dhe të drejtën e tij për të zbritur këtë tatim mbi vlerën e shtuar, në përputhje me paragrafin "e" më poshtë.

b) Në lidhje me furnizimin e mallrave dhe shërbimeve brenda vendit nga një Kontraktues i Nivelit të Parë ose një Kontraktues i Nivelit të Dytë, vetëm marrësi i mallrave dhe/ose i shërbimeve do të jetë i detyruar të paguajë Tatimin mbi Vlerën e Shtuar ndaj administratës tatimore dhe ka të drejtën për të zbritur këtë tatim mbi vlerën e shtuar, në përputhje me paragrafin "e" më poshtë;

c) Nuk do të llogaritet ose të faturohet TVSH-ja në faturat e lëshuara nga furnizuesi, në lidhje me furnizimet e përcaktuara në paragrafin "b" më sipër. Trajtimi i furnizimeve, siç parashikohet në paragrafin "b" më sipër, nuk do të ndikojë të drejtën e furnizuesit për të kërkuar kreditimin e TVSH-së për blerjet e lidhura me to, në të njëjtën mënyrë sikur furnizimi të ishte një furnizim me TVSH, në përputhje me rregullat e përgjithshme të TVSH-së.

d) i. për qëllimet e trajtimit të TVSH-së, të përcaktuar në paragrafët "a" deri "c" më sipër, Investitori i Projektit mund të propozojë në total deri në 80 (në total) Kontraktues të Nivelit të Parë dhe Kontraktues të Nivelit të Dytë (në çdo kohë) dhe, gjithashtu, do të ketë të drejtën të zëvendësojë çdo Kontraktues të Nivelit të Parë ose Kontraktues të Nivelit të Dytë të propozuar. Çdo propozim ose zëvendësim i një Kontraktuesi të Nivelit të Parë ose një Kontraktuesi të Nivelit Dytë do të hyjë në fuqi, në përputhje me paragrafin (d)(iv) më poshtë:

ii. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është e autorizuar të miratojë propozimet e Kontraktuesve të Nivelit të Parë ose Kontraktuesve të Nivelit të Dytë, veç Kontraktuesve të propozuar, në përputhje me paragrafin (d)(i) më lart, nëse kërkohet nga Investitori i Projektit. Dhënia e miratimit nuk mund të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme;

iii. trajtimi i TVSH-së, siç parashikohet në këtë nen 24.15, do të zbatohet për furnizimet e bëra nga Kontraktuesit e Nivelit të Parë dhe Kontraktuesit e Nivelit të Dytë të propozuar.

iv. Investitori i Projektit do të përgatitë një listë (lista e kontraktuesve), duke përfshirë të gjithë Kontraktuesit e Nivelit të Parë dhe Kontraktuesit e Nivelit të Dytë të propozuar. Lista e Kontraktuesve do të dorëzohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Investitori i Projektit do të paraqesë një listë të përditësuar të Kontraktuesve, në rast të ndonjë ndryshimi. Këto ndryshime do të hyjnë në fuqi tri javë pas dorëzimit të listës së përditësuar të Kontraktuesve.

e) Importuesi, sipas paragrafit "a" më sipër, si dhe marrësi i furnizimeve të mallrave ose të shërbimeve, në përputhje me paragrafin "b" më sipër, do të lëshojë një faturë tatimore shitjeje për veten, ku do të rezultojë si furnizues dhe blerës i mallrave dhe i shërbimeve në të njëjtën kohë (autofaturimi) dhe ka të drejtë që në mënyrë të menjëhershme të zbresë nga TVSH-ja e llogaritur mbi shitjet që u korrespondojnë këtyre importeve ose furnizimeve të mallrave ose të shërbimeve, TVSH-në e zbatuar në këto blerje në të njëjtën shumë; pra nuk do të bëhet një pagesë me para në dorë pranë administratës tatimore, me kusht që marrësi i furnizimeve të ketë të drejtë ta zbresë këtë TVSH në blerje, sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit të zbatueshëm.

f) Investitori i Projektit do të krijojë një sistem të rregullave të përputhshmërisë (Rregullat e Përputhshmërisë) për Kontraktuesit e Nivelit të Parë dhe Kontraktuesit e Nivelit të Dytë, të cilët janë renditur në Listën e Kontraktuesve dhe do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të siguruar zbatimin e regjimit të TVSH-së, siç përcaktohet në këtë nen 24.15. Nëse Investitori i Projektit vihet në dijeni për shkeljen ose abuzimin me Rregullat e Përputhshmërisë ose regjimin e TVSH-së nga Kontraktuesi i Nivelit të Parë ose Kontraktuesi i Nivelit të Dytë, në një mënyrë thelbësore, Investitori i Projektit do të njoftojë Shtetin, se Kontraktuesi i Nivelit të Parë dhe Kontraktuesi i Nivelit të Dytë, që ka kryer shkeljen, është hequr me efekt të menjëhershëm nga Lista e Kontraktuesve dhe regjimi i TVSH-së, i përcaktuar në këtë nen, nuk do të zbatohet më ndaj këtij Kontraktuesi të Nivelit të Parë ose Kontraktuesi të Nivelit të Dytë (sipas rastit).".

NËNSHKRUESIT:
QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Nga:
Ministri i Financave dhe Ekonomisë
Arben Ahmetaj

Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë
Damian Gjiknuri

INVESTITORI I PROJEKTIT
Trans Adriatic Pipeline AG

Nga: Luca Schieppati
Pozicioni: Drejtor i Përgjithshëm

Nga: Walter Peeraer
Pozicioni: President

AKT NORMATIV
Nr. 1, datë 26.7.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 109/2017, "PËR BUXHETIN E VITIT 2018"

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", bëhen këto ndryshime :

Neni l

Nenet 2, 3, 4, 5 dhe 8 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2018 është:

Të ardhurat	353 354	milionë lekë;
Shpenzimet	385 720	milionë lekë;
Deficiti	32 366	milionë lekë.

Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2018 është:

Të ardhurat	46 221	milionë lekë;
Nga të cilat:		
- transferta e pakushtëzuar nga buxheti qendror	16 580	milionë lekë;
- transferta specifike	7 454	milionë lekë;
- të ardhura të tjera	22 187	milionë lekë;
Shpenzimet	46 221	milionë lekë.

Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2018 është:

l. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror

Të ardhurat, gjithsej	122 276	milionë lekë;
Nga të cilat:		
- kontributet	77 160	milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	40 646	milionë lekë;
- transferta nga buxheti për indeksimin e pensioneve	1 470	milionë lekë;
- transferta për bonusin e pensionistëve	3 000	milionë lekë
Shpenzimet	122 276	milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe të kategorive të veçanta të personave të vetëpunësuar, duke mbuluar nga buxheti i shtetit diferencën midis këtyre kontributeve me masën e kontributit të përcaktuar për personat e vetëpunësuar në qytet. Për vitin 2018, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve të sigurimit shoqëror dhe programeve të tjera të veçanta e suplementare, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Skema e sigurimit suplementar

Të ardhurat, gjithsej	5 809	milionë lekë;
Nga të cilat:		
- kontributet	1 376	milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	4 333	milionë lekë;
- fondi për indeksimin e pensioneve	100	milionë lekë;
Shpenzimet	5 809	milionë lekë.

Fondi për indeksimin e pensioneve është 1 570 milionë lekë. Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2 550 milionë lekë dhe janë të ndara sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.

Neni 5

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2018 është:

Të ardhurat, gjithsej,	40 400	milionë lekë;
Nga të cilat:		
- kontributet dhe të tjera	12 526	milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	27 874	milionë lekë;
Shpenzimet	40 400	milionë lekë.

Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.

...

Neni 8

Të ardhurat e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Grantet	14 500	milionë lekë;
Të ardhurat tatimore	313 097	milionë lekë;
Të ardhurat jotatimore	25 757	milionë lekë.”.

Neni 2

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Shpenzime të buxhetit qendror	379 120	milionë lekë;
Fondi rezervë	2 600	milionë lekë;
Kontingjencë për risqet e borxhit	4 000	milionë lekë.”.

b) Tabela 1 e përmendur në nenin 10 zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numërtim, që i bashkëlidhet këtij akti normativ dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 3

Në nenin 11 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Numri i përgjithshëm i punonjësve në organikë bëhet 81 672 veta.

b) Tabela 2, e përmendur në nenin 11, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numërtim, që i bashkëlidhet këtij akti mormativ dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 4

Neni 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 13

Fondi rezervë i buxhetit prej 2 600 milionë lekësh përdoret nga Këshilli i Ministrave:

- deri në 1 800 milionë lekë, për raste të paparashikuara të institucioneve buxhetore;

- deri në 800 milionë lekë, për krijimin dhe funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë, pas miratimit paraprak nga Kuvendi.

Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4 000 milionë lekësh përdoret për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.”.

Neni 5

Neni 14 shfuqizohet.

Neni 6

Tabela 3 dhe aneksi 3, që përmenden në nenin 16, zëvendësohen përkatësisht me tabelën dhe aneksin me të njëjtin numërtim, që i bashkëlidhen këtij akti normativ dhe janë pjesë përbërëse të tij.

Neni 7

Ky akt normativ hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

BUXHETI 2018 SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

Kodi	Emërtimi i institucionit / programit	Totali i shp. korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale	
1	**Presidenca**	**229,500**	**18,000**	**0**	**18,000**	**247,500**
01120	Veprimtaria e Presidentit	229,500	18,000	0	18,000	247,500
2	**Kuvendi**	**1,069,200**	**124,000**	**25,000**	**149,000**	**1,218,200**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	383,400	124,000	25,000	149,000	532,400
01120	Veprimtaria ligjvënëse	685,800	0	0	0	685,800
3	**Kryeministria**	**446,000**	**209,000**	**526,904**	**735,904**	**1,181,904**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	446,000	209,000	526,904	735,904	1,181,904
5	**Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**	**5,967,968**	**1,770,624**	**2,762,714**	**4,533,338**	**10,501,306**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	339,428	10,000	6,300	16,300	355,728
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,535,600	354,000	240,650	594,650	2,130,250
04240	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	736,430	800,000	976,122	1,776,122	2,512,552
04250	Zhvillimi Rural duke mbësht. prodh. Bujq., blek., agroind. dhe market.	2,924,560	458,682	1,197,662	1,656,344	4,580,904
04860	Këshillimi dhe informacioni bujqësor	212,650	35,000	0	35,000	247,650
05470	Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore	16,000	0	0	0	16,000
04230	Mbështetje për peshkimin	113,500	83,942	201,150	285,092	398,592
05640	Administrimi i ujërave	89,800	29,000	140,830	169,830	259,630
6	**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**	**5,557,830**	**23,575,408**	**18,826,800**	**42,402,208**	**47,960,038**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	680,700	51,287	0	51,287	731,987
04520	Transporti rrugor	1,911,960	15,405,041	6,595,000	22,000,041	23,912,001
04540	Transporti detar	108,260	62,800	0	62,800	171,060
04550	Transporti hekurudhor	423,680	65,000	120,000	185,000	608,680
04560	Transporti ajror	15,610	29,000	0	29,000	44,610
06370	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	1,062,780	3,963,000	5,591,800	9,554,800	10,617,580
06220	Menaxhimi i mbetjeve urbane	753,000	1,564,272	450,000	2,014,272	2,767,272
04320	Mbështetje për energjinë	90,900	1,804,808	5,660,000	7,464,808	7,555,708
04430	Mbështetje për burimet natyrore	159,500	311,700	0	311,700	471,200
04440	Mbështetje për industrinë	253,740	153,000	0	153,000	406,740
06180	Planifikimi urban	97,700	165,500	410,000	575,500	673,200
10	**Ministria e Financave dhe Ekonomisë**	**51,705,165**	**2,712,153**	**1,606,982**	**4,319,135**	**56,024,300**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	692,245	486,000	562,982	1,048,982	1,741,227
01120	Menaxhimi i shpenzimeve publike	532,500	10,000	0	10,000	542,500
01130	Ekzekutimi i pagesave të ndryshme	330,000	180,000	0	180,000	510,000
01140	Menaxhimi i të ardhurave tatimore	2,366,267	383,000	0	383,000	2,749,267
01150	Menaxhimi i të ardhurave doganore	3,230,155	290,000	225,000	515,000	3,745,155
01160	Lufta kundër transaksioneve financiare joligjore	78,800	19,000	0	19,000	97,800
04130	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	265,000	167,300	127,000	294,300	559,300
04160	Mbështetje për mbikëq. e tregut, infrast. e cilës. dhe pron. industr.	327,000	29,000	0	29,000	356,000
10220	Sigurimi shoqëror	40,010,350	0	0	0	40,010,350
10550	Tregu i punës	1,674,808	141,031	0	141,031	1,815,839
04170	Inspektimi në punë	188,640	10,000	0	10,000	198,640
09240	Arsimi i mesëm (profesional)	1,680,600	775,622	692,000	1,467,622	3,148,222
06190	Strehimi	328,800	221,200	0	221,200	550,000
11	**Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë**	**34,540,242**	**3,364,000**	**150,000**	**3,514,000**	**38,054,242**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	725,042	72,000	0	72,000	797,042
09120	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	20,416,580	1,677,947	0	1,677,947	22,094,527
09230	Arsimi i mesëm (i përgjithshëm)	6,072,617	972,115	0	972,115	7,044,732
09450	Arsimi Universitar	6,795,203	370,000	100,000	470,000	7,265,203
09770	Fonde për shkencën	318,300	32,122	50,000	82,122	400,422
08140	Zhvillimi i sportit dhe rinisë	212,500	239,816	0	239,816	452,316
12	**Ministria e Kulturës**	**1,371,532**	**643,000**	**0**	**643,000**	**2,014,532**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	153,276	0	0	0	153,276
08220	Trashëgimia kulturore dhe muzetë	450,207	193,000	0	193,000	643,207
08230	Arti dhe kultura	768,049	450,000	0	450,000	1,218,049
13	**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**	**55,868,729**	**1,840,000**	**764,400**	**2,604,400**	**58,473,129**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	454,940	9,430	0	9,430	464,370
07220	Shërbimet e kujdesit parësor	8,368,220	399,316	233,600	632,916	9,001,136
07330	Shërbimet e kujdesit dytësor	20,929,362	1,108,034	460,800	1,568,834	22,498,196
07450	Shërbimet e shëndetit publik	2,991,377	0	0	0	2,991,377
07460	Shërbimi kombëtar i urgjencës	323,300	243,270	0	243,270	566,570
10430	Përkujdesja sociale	21,737,930	79,950	70,000	149,950	21,887,880
10460	Përfshirja sociale	16,800	0	0	0	16,800
01190	Rehabilitimi i të përndjekurve politik	1,046,800	0	0	0	1,046,800
14	**Ministria e Drejtësisë**	**9,742,600**	**595,042**	**245,000**	**840,042**	**10,582,642**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	554,000	125,500	195,000	320,500	874,500
01120	Publikimet zyrtare	56,800	15,000	0	15,000	71,800
01130	Mjekësia ligjore	79,000	10,000	0	10,000	89,000
03440	Sistemi i burgjeve	5,360,600	400,000	50,000	450,000	5,810,600
03350	Shërbimi i përmbarimit gjyqësor	160,000	10,000	0	10,000	170,000
01160	Shërbimet për çështjet e birësimeve	14,500	2,000	0	2,000	16,500
01180	Shërbimi i kthimit dhe kompensimit të pronave	3,355,000	25,542	0	25,542	3,380,542
03490	Shërbimi i provës	162,700	7,000	0	7,000	169,700
15	**Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**	**2,534,180**	**153,000**	**270,000**	**423,000**	**2,957,180**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	134,600	102,000	0	102,000	236,600

01120	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	2,097,750	10,000	0	10,000	2,107,750
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ-së	198,500	0	0	0	198,500
01150	Mbështetja institucionale për procesin e integrimit	103,330	41,000	270,000	311,000	414,330
16	**Ministria e Brendshme**	**18,649,052**	**1,550,304**	**897,000**	**2,447,304**	**21,096,356**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	1,043,759	63,000	0	63,000	1,106,759
03140	Policia e Shtetit	14,581,184	1,322,176	826,643	2,148,819	16,730,003
03150	Garda e Republikës	1,502,769	160,000	0	160,000	1,662,769
01160	Prefekturat dhe funksionet e deleguara të pushtetit vendor	527,240	5,128	70,357	75,485	602,725
01170	Shërbimi i gjendjes civile	994,100	0	0	0	994,100
17	**Ministria e Mbrojtjes**	**17,553,448**	**2,235,000**	**150,000**	**2,385,000**	**19,938,448**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	1,211,141	38,000	0	38,000	1,249,141
02120	Forcat e luftimit	4,721,532	1,980,000	0	1,980,000	6,701,532
09430	Arsimi ushtarak	571,750	0	0	0	571,750
02150	Mbështetja e luftimit	4,758,390	63,000	0	63,000	4,821,390
07340	Mbështetje për Shëndetësinë	881,069	29,000	0	29,000	910,069
10270	Mbështetje sociale për ushtaraket	4,974,600	0	0	0	4,974,600
10910	Emergjencat Civile	434,966	125,000	150,000	275,000	709,966
18	**Shërbimi Informativ Shtetëror**	**1,480,000**	**64,000**	**0**	**64,000**	**1,544,000**
03520	Veprimtaria informative shtetërore	1,480,000	64,000	0	64,000	1,544,000
19	**Drejtoria e Radiotelevizionit**	**565,000**	**200,000**	**0**	**200,000**	**765,000**
08310	Shërbimet për shqiptaret jashtë kufirit	240,000	0	0	0	240,000
08520	Projekte teknike për futjen e teknologjive të reja	200,000	200,000	0	200,000	400,000
08330	Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarëkombëtare	65,000	0	0	0	65,000
08340	Orkestra simfonike e RTSH-së dhe e kinematografisë	60,000	0	0	0	60,000
